



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "ARTMOTION" SH.P.K.  
Numri i biznesit - 71364887  
Person i autorizuar – Valon SHALA  
OSHMA KINO 1  
Rr/Lidhja e Pejës, Zona Industriale  
Prishtinë

Ref:1805/607/LIC/ni

**VENDIM**

për ndryshim të emrit të OSHMA KINO 1 në "ARTKINO 1"

---

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. KINO 1 është Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizual, i licencuar për transmetim të programit përmes operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë. Vendimi për licencimin e OSHMA KINO 1 është lëshuar nga ana e KPM-së, më datën 26 shkurt 2018.
3. Më datën 16 maj 2018, personi i autorizuar i OSHMA KINO 1 ka parashtruar një kërkesë me shkrim, duke kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e emrit në "ARTKINO 1".

**Arsyetimi**

4. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, KPM – 2017/02, respektivisht Neni 21, paragrafi 7, thekson: *"I Licencuari duhet ta identifikojë përmbajtjen e tij me anë të logos, e cila mund të ndryshohet vetëm me miratim paraprak nga KPM-ja."*
5. Komisioni konstaton se, emri i propozuar për ndryshim "ARTKINO 1", nuk është i ngjajshëm me asnjë nga emrat e të licencuarve të KPM-së dhe si i tillë, gjatë përdorimit të tij për identifikim, nuk do të shkaktoj konfuzion tek shikuesit, prandaj, kërkesa për ndryshim të emrit nga KINO 1 në "ARTKINO 1" i plotëson kriteret për miratim.

6. Komisioni konsideron se, kërkesa e OSHMA KINO 1 për ndryshim të emrit është parashtruar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim.

**Vendim**

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datë 4 korrik 2018, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e emrit të OSHMA KINO 1 në ARTKINO 1.
8. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



09.07.2018.

datë